



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government Administration

THIRRJE PËR PROPOZIM

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) i fton të gjitha organizatat joqeveritare (OJQ) që veprojnë në komunat e themeluara në kuadër të procesit të decentralizimit, të aplikojnë për realizimin e projektit “Promovimi dhe Afirmimi i të Drejtave të Komuniteteve”.

Kërkesat (Projekt-propozimet) duhet të përmbajnë:

1. Projekt-propozimin;
2. Buxhetin e detalizuar, si dhe arsyetimin e linjave buxhetore;
3. Afatin (dinamik) kohor për implementim;
4. Përshkrimin e detalizuar të kapaciteteve menaxhuese të organizatës (*personeli, pajisjet dhe aftësitë për të menaxhuar buxhetin e paraparë për aktivitete, etj*);
5. Një kopje që dokumenton regjistrimin e OJQ-së/ve, konform ligjeve të aplikueshme të Republikës së Kosovës;
- 6 . Referencat për punë të ngjashme;
7. Aplikantët duhet të kenë xhirollogari në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.

Të gjithë të interesuarit për aplikim mund të marrin informata në Departamentin për Transparencë dhe Performancë Komunale në MAPL, përmes tel: 038 200 35 509 , ose në uebfaqen e MAPL-së: <http://www.mapl-ks.org>

Propozimet e kompletuara e të mbyllura në zarf mund të dorëzohen në Arkivin e MAPL ish-“Rilindja”, kati XII. Data e fundit për aplikim është deri më 12 prill 2013, në ora 14:00.